



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 36, datë 25.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR NDRYSHIMIN E PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT
PËR OBJEKTIN: "GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 11, 12, 13, 14, 15 DHE 16
KATE MBI TOKË, ME 3 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË
BULEVARDIN "GJERGJ FISHTA", BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Arlis Ndërtim" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e lejes për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për objektin: "Godinë banimi dhe shërbimesh 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 kate mbitokë, me 3 kate nëntokë", me vendndodhje në Bulevardin "Gjergj Fishta", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Arlis Ndërtim" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELENDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/12 / 2025